

C.nr.401/14

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr.” [REDAKTUAR] kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizajt, për çështjen juridike, borxh, vlera e kontestit 250 €, pas seancës publike të mbajtur më 27.12.2016, në prezencën e paditësit dhe në mungesë të paditurit mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** kërkesë padia e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr.” [REDAKTUAR], e paraqitur kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR]-Komuna Ferizajt, si e bazuar.

**II. DETYROHET** i padituri, që paditësit t’i paguajnë shumën prej 250 € (dyqindë e pesëdhjetë ) euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së padisë dt.06.06.2014, e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 €, të gjitha në afat prej 7 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m

Paditësi në fjalën e tij ka deklaruar, mbesë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, precizimin e bërë në seancën e dt.07.12.2016, ku nga shuma prej 1.855 euro, ashtu siç është në padi, e ka precizuar padinë duke e zbritur atë në shumë prej 250 euro, njëherit ka shtuar se nga provat e administruara, u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë, se i padituri ashtu siç është përcaktuar në nenin 2 pika 2.2 , e kontratës mbi qiranë të lokalit afarist , ka

filluar ta shfrytëzoj këtë lokal nga dt.01.01.2014, të pëtpiluar dhe nënshkruar tek noteri me nr. LRP.nr.3044/2014 dt.15.04.2014,e të cilën e ka shfrytëzuar vetëm 4 muaj , në të cilën periudhë ka mbetur pa përmbushur obligimin ndaj KEK-ut, për shfrytëzimin e energjisë elektrike, por menenqëse i njëjti në ndërkohë një pjesë të saj më ka përmbushur mua , por ka mbetur e pa paguar edhe shuma prej 250 euro.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si a bazuar, dhe të detyrohet i padituri , paditësit t'ia përmbush obligimin në emër të borxhit shumë e precizuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata seancën gjyqësore e ka mbajtur në mungesë të paditurit në bazë të nenit 423.4 të LPK-së, pasi që i njëjti e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullte, siç shihet nga fletëkthesa e ardhur e dt.09.12.2016, në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre:U lexua padia e paditësit C.nr. 401/14 dt.06.06.2014, Kontrata mbi qiranë e lokalit afarist, e përpiluar dhe vërtetuar tek noteri Selatin Shahini me nr. LRP.nr.3044/2014 dt.15.04.2014, Transaksioni i konsumatorit me shifër DFE 9012224 i dt.16.12.2016, Pasqyra e obligimeve lëshuar nga KRM-Bifurkacioni Ferizaj për periudhën 01.01.2013 deri më dt.06.05.2014

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar.

Nga provat e administruara u vërtetua se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë për marrjen në shfrytëzim me qira të lokalit afarist me paditësin me nr. LRP.nr.3044/2014, nr. ref.1517/2014, më dt. 15.04.2014, të cilën shumë e padituri pjesërisht e ka paguar kurse kanë mbetur pa paguar shumë prej 250 €, e cila përcaktohet në nenin 2 pika 2.2 , e kontratës mbi qiranë të lokalit afarist , ka filluar ta shfrytëzoj këtë lokal nga dt.01.01.2014,e të cilën e ka shfrytëzuar vetëm 4 muaj , në të cilën periudhë ka mbetur pa përmbushur obligimin ndaj KEK-ut, për shfrytëzimin e energjisë elektrike, në të cilat prova vërtetohet se i padituri me paditësin janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete sipas nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 lidhur me nenin 583 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e

administruara dhe atë nga kontrata mbi qiranë e lokalit afarist, e përpiluar dhe vërtetuar tek noteri [REDACTED] me nr. LRP.nr.3044/2014 dt.15.04.2014.

Meqenëse i padituri nuk është paraqitur në gjykatë, gjykata është kujdesur që sipas detyrës zyrtare se mos po iu cenohen të drejtat dhe detyrimet e të paditurit në këtë çështje kontestimore, ku pas administrimi të provave ka konstatuar se i padituri nuk e kanë përmbushur detyrimin ndaj paditësit, andaj edhe kanë vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ia ka njohur kamatën ligjore prej 8%, nga dt.06.06.2014 në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 15 € dhe aktgjykim prej, 15 €, gjithsej në lartësi prej 30 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.401/14 më dt.27.12.2016



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

